



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.15, datë 29/05/2023

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIMIN E LEJES PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR SIPËRFAQËSOR PËR QËLLIME
SANITARE ME NR.SERIE:00090, MIRATUAR NGA KBU MAT ME
VENDIM NR.2, DATË 26.07.2018, SUBJEKTIT “TETE ALBANIA
TUNNEL MINING” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime sanitare me Nr.serie:00090, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.2, datë 26.07.2018, subjektit “Tete Albania Tunnel Mining” sh.p.k, me vendndodhje, Nj.A Orosh, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë, sipas këtyre koordinatave:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- $X=503565.5$; $Y=4641418.1$; $Z=603$ m.m.n.d;

- Prurja mesatare : $Q_{mes}=5$ l/s

- Sasia e ujit në përdorim : $Q=1$ l/s

- Qëllimi i përdorimit : Sanitare në Fabrikën e Pasurim mineral bakri.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

